

VENDIM
Nr. 7, datë 9.4.2012

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHA UK SARANDË

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik”, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

VENDOSI:

1. Të miratojë për sh.a. UK Sarandë:

a) tarifat e ujit për konsum publik, si më poshtë:

	Për ujin e pijshëm	Për ujërat e ndotura
Konsumator familjar	44 lekë/m ³	16 lekë /m ³
Institucione buxhetore	120 lekë/m ³	25 lekë/m ³
Ente private	120 lekë/m ³	25 lekë/m ³
Shitje uji me shumicë (Komuna Aliko, Mesopotam, Dhiver, Finiq)	25 lekë/m ³	
b) tarifë fikse shërbimi	100 lekë/muaj/klient.	

2. Pagesa rregullatore për sh.a. UK Sarandë do të jetë 1 % e të ardhurave vjetore të llogaritura.

3. Ky vendim hyn në fuqi më 1.5.2012 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi